

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut



POLITIKË **për vazhdueshmërinë në punë** **në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut**

shtator, 2011

Në mbështetje të nenit 47, paragrafit (1), pikës 9) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.110/21), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi

POLITIKË
për vazhdueshmërinë në punë
në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut
(Tekst i konsoliduar jozyrtar)¹

I. Dispozita të përgjithshme

1. Me Politikën për vazhdueshmërinë në punë në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: PVP) përcaktohet vendosja e kornizës përkatëse për aktivitete efikase dhe të koordinuara me të cilat duhet të ruhet reputacioni dhe funksionet vitale të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, (në tekstin e mëtejshëm: Banka Popullore), si dhe mënyrën e sigurimit të vazhdueshmërisë në punë të Bankës Popullore në gjendje krize.
2. Qëllimi i PVP-së është të identifikojë rreziqet dhe kërcënimet e mundshme për funksionimin normal të Bankës Popullore, të sigurojë vazhdueshmëri në realizimin e proceseve të punës dhe siguri punonjësve të Bankës Popullore në gjendje krize.
3. Gjendje krize, në kuptim të pikës 2) nga kjo politikë, paraqet gjendje gjatë së cilës janë të dëmtuara funksionimi normal dhe proceset e punës në Bankën Popullore ose paraqet ngjarje që rrezikon sigurinë dhe e cila mund të sjellë humbje të jetës së njeriut ose dëm material dhe reputacional të Bankës Popullore.
4. Funksionimi i Bankës Popullore në gjendje lufte rregullohet me akte të veçanta të Bankës Popullore dhe në pajtim me Ligjin e Mbrojtjes dhe rreguloret me fuqi ligjore për punë në gjendje lufte.
5. Me PVP-në minimalizohet ndikimi negativ nga:

¹ **Tekst i spastruar jozyrtarisht i Politikës së Vazhdueshmërisë në Punë në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë P.nr.02-15/IX-4/2011 prej 15.09.2011 e ndryshuar dhe plotësuar më 28 nëntor 2013 nën P nr. 02-15/III-1/2013, e ndryshuar më 24 mars 2016 nën P nr. 02-15/III-1/2016, Vendim për ndryshimin e Politikës për vazhdueshmërinë në punë në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut V. nr. 02-15/IV-4/2020 nga 20 marsi 2020, e ndryshuar dhe plotësuar më 4 qershor 2021 nën P. nr. 02-15/VIII-1/2021 dhe e ndryshuar me Politikë për vazhdueshmërinë në punë në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut P. nr. 02-15/XVI-1/2022 nga 30 shtatori 2022, Politikë për ndryshimin e Politikës për vazhdueshmërinë në punë në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut Nr. 02-3614/5 nga 2 shkurti 2023, Politikë për ndryshimin e Politikës për vazhdueshmërinë në punë në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 02-34557/7 nga 9 tetori 2024 dhe Politikë për ndryshimin e Politikës për vazhdueshmërinë në punë në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 02-40305/12 nga 28 nëntori 2024.**

- a) definim i paqartë dhe i papërshtatshëm i roleve dhe detyrave të pjesëmarrësve të ndryshëm të cilët janë përgjegjës për vazhdueshmërinë në punë, që mund të sjell deri në vendimarrje të pasuksesshme dhe situata konflikti;
- b) humbje e kohës së vlefshme nëse pjesëmarrësit nuk e dinë saktësisht çfarë duhet të ndërmerret në situatë krize;
- c) komunikim i dobët i brendshëm në gjendje krize që mund të sjellë dëme të mëdha në punë;
- ç) komunikim i dobët i jashtëm i cili mund të dëmtoj reputacionin e Bankës Popullore.

II. Sigurim i vazhdueshmërisë në punë të Bankës Popullore

- 6. Për mbrojtje të organizuar dhe në kohë të njerëzve dhe të mirave materiale nga pasojat e situatës së krizës, në Bankën Popullore formohen:
 - a) Shtabi i Emergjencës (në vazhdim të tekstit: ShE);
 - b) Gjashtë grupe të krizave (në vazhdim të tekstit: GK);
 - grupë krize e sistemeve të pagesave (SP);
 - grupë krize e operacioneve të thesarit (OTh);
 - grupë krize e operacioneve të tregjeve financiare (TF);
 - grupë krize e teknologjive të informacionit (IT);
 - grupë krize e financave, kontabilitetit dhe kontrolleve (FKK);
 - grupë krize e njësive tjera organizative (NjO);
 - c) Person përgjegjës për sigurim të vazhdueshmërisë në punë (në vazhdim të tekstit: PSVP).

Shtab i Emergjencës

- 7. Në gjendje krize, ShE-ja është organi më i lartë për vendimarrje dhe udhëheqje në Bankën Popullore, në lidhje me vendimarrjen për zbatimin e aktiviteteve lidhur me krizën.

ShE-ja është e përbërë nga kryetari dhe 4 anëtarët.

Kryetar i ShE-së është guvernatori i Bankës Popullore. Kryetari dhe anëtarët e ShE-së kanë një numër të caktuar zëvendës të emëruar. Anëtarët e ShE-së dhe zëvendësit e tyre i emëron Këshilli i Bankës Popullore, me propozim të guvernatorit, në periudhë 4 vjeçare.

Kompetencat dhe përgjegjësitë e ShE-së janë:

- a) të deklaroj gjendje krize dhe ndërprerje të një gjendjes krize;
- b) të vendos për zbatimin e aktiviteteve lidhur me krizën;
- c) ti shqyrtoj raportet e GK-së përkatëse për dëmet e pësura dhe pasojat nga kriza;
- ç) të nënshkruaj marrëveshje me persona të tretë të cilët janë të nevojshëm për tejkalim të krizave;
- d) të aprovoj testim dhe kontrollim të sistemeve kontrolluese për zbatim efektiv të PVP-së;
- dh) të informoj për gjendjet e krizës dhe të bashkëpunoj me trupa të ngjajshëm krize të institucioneve financiare ose shtetërore.

ShE-ja duhet të siguroj lokacion të përshtatshëm alternativ në të cilën do ti realizoj operacionet e veta në kushte të padisponueshmërisë së lokacionit primar.

Anëtarët e ShE-së takohen të paktën një herë në vit, me qëllim të ndjekjes së realizimit të PVP-së, si dhe të rishikojnë PVP-të dhe Planet për sigurimin e vazhdimësisë së punës.

Mënyra e punës së ShE-së rregullohet me rregullorën e punës.

Grupet e krizës

8. Për organizim të punës në gjendje krize në Bankën Popullore formohen grupe të krizave.

Çdo grup i krizës ka udhëheqës dhe të paktën 4 anëtarë, dhe atë:

a) Grupë krize e SP-së:

- drejtori i Drejtorisë së Sistemeve të Pagesave në kapacitetin e udhëheqësit të GK-së;
- drejtori i Drejtorisë së Pagesave dhe Operacioneve të Prapavisë në kapacitetin e udhëheqësit të GK-së;
- përfaqësues të drejtorive përkatëse dhe njësive të posaçme organizative të cilët në realizimin e punëve dhe detyrave të veta varen prej shërbimeve që i siguron Drejtoria e Sistemeve të Pagesave;
- përfaqësues të drejtorive përkatëse dhe njësive të posaçme organizative nga shërbimet e të cilave varet funksionimi i Drejtorisë së Sistemeve të Pagesave dhe Drejtorisë së Pagesave dhe Operacioneve të Prapavisë;

b) Grupë krize e TI-së:

- drejtori i Drejtorisë së Teknologjisë Informative në kapacitetin e udhëheqësit të GK-së;
- përfaqësues të drejtorive përkatëse dhe njësive të posaçme organizative të cilët në realizimin e punëve dhe detyrave të veta varen prej shërbimeve që i siguron Sektori i Teknologjisë Informative;
- përfaqësues të drejtorive dhe njësive përkatëse dhe njësitë e posaçme organizative nga shërbimet e të cilëve varet puna e Sektorit të Teknologjisë Informative.

c) Grupë krize e OTh-së:

- drejtori i Drejtorisë së Operacioneve të Thesarit në kapacitetin e udhëheqësit të GK-së;
- përfaqësues të drejtorive përkatëse dhe njësive të posaçme organizative të cilët në realizimin e punëve dhe detyrave të veta varen prej shërbimeve që i siguron Drejtoria e Operacioneve të Thesarit;
- përfaqësues të drejtorive përkatëse dhe njësitë e posaçme organizative nga shërbimet e të cilëve varet puna e Drejtorisë së Operacioneve të Thesarit.

ç) Grupë krize e TF-së:

- drejtori i Drejtorisë së Operacioneve të Tregjeve Financiare (në tekstin e mëposhtëm: Drejtoria e TF), në kapacitetin e udhëheqësit të GK-së;
- përfaqësues të drejtorive përkatëse dhe njërive të posaçme organizative të cilët në realizimin e punëve dhe detyrave të veta varen prej shërbimeve që i siguron Drejtoria e TF-së;
- përfaqësues të drejtorive përkatëse dhe njësitë e posaçme organizative nga shërbimet e të cilëve varet puna e Drejtorisë e TF-së.

d) Grupë krize e FKK-së:

- drejtori i Drejtorisë së Financave, Kontabilitetit dhe Kontrollit (në tekstin e mëposhtëm: Drejtoria e FKK-së), në kapacitetin e udhëheqësit të GK-së;
- përfaqësues të drejtorive përkatëse dhe njërive të posaçme organizative të cilët në realizimin e punëve dhe detyrave të veta varen prej shërbimeve që i siguron Drejtoria e FKK-së;
- përfaqësues të drejtorive përkatëse dhe njësitë e posaçme organizative nga shërbimet e të cilëve varet puna e Drejtorisë e FKK-së.

dh) Grupë krize e NjO-së:

- drejtori i Drejtorisë së Mirëmbajtjes Teknike, Sigurimit dhe Arkivimit në kapacitetin e udhëheqësit të GK-së;
- drejtorët e drejtorive tjera të cilët nuk janë të përfshirë në nënpikat a), b), c), ç) dhe d), Shefi i Kabinetit, auditori kryesor i brendshëm, personi përgjegjës kryesor / juristi përgjegjës kryesor nga Zyra e strategjisë dhe parandalimit, mbikëqyrësi përgjegjës kryesor për sisteme informative dhe personi i autorizuar nga guvernatori i cili udhëheq me njësitë e veçanta organizative Muzeu i Bankës Popullore dhe Biblioteka dhe Arkivi i Bankës Popullore.

Udhëheqësi dhe anëtarët e grupeve të krizës duhet të kenë një numër të përshtatshëm të zëvendësve.

Udhëheqësit, anëtarët e grupeve të krizës dhe zëvendësuesit e tyre i emëron guvernatori i Bankës Popullore.

Takimet e GK-së i thir udhëheqësi i GK-së. Çdo anëtar i ShE-së, Gk-së ose PSVP-së mund të bëjë thirrje për takim.

Gupet e krizës janë përgjegjëse për:

- a) përcaktimin e gjendjes (vëllimit) të krizës ose fatkeqësisë;
- b) njoftim për masat e nevojshme të sigurisë për punonjësit;
- c) vlerësimin e dëmeve dhe pasojave për Bankën Popullore;
- ç) dhënien e propozimeve deri te ShE-ja për shpalljen e gjendjes krize dhe masave të nevojshme për minimizimin e pasojave;
- d) propozim të Planit të Rimëkëmbjes nga gjendja e krizës në kuadër të fushëveprimit të saj;
- dh) propozim për organizimin e punës me vëllim të reduktuar gjatë krizës;
- e) raportime të rregullta të ShE-së për gjendjen dhe rrjedhën e tejkalimit të krizës;
- ë) përgaditje dhe dorëzim të raportit final deri te ShE-ja mbi krijimin dhe tejkalimin e krizës;

f) bashkëpunim gjatë përgaditjes së testimit të planeve për vazhdueshmëri në punë dhe realizimin e testeve dhe simulimeve të PVP-së në domenin e funksionimit të saj.

Udhëheqësit e grupeve të krizës i kanë këto detyra dhe përgjegjësi:

- a) propozimin e anëtarëve për grupën e krizës;
- b) organizimin dhe koordinimin e punës së grupit të krizës;
- c) identifikimin e ndërvarësive tek funksionet/proceset kritike punuese;
- ç) bashkëpunimin e ndërsjelltë ndërmjet grupeve tjera të krizës në Bankën Popullore;
- d) organizim të punës së grupeve punuese për rindërtimin e proceseve punuese (GPR);
- dh) dhënien e propozimeve për rishikim të Planeve të Rimëkëmbjes prej fatkeqësive në kuadër të grupit të vet të krizës;
- e) iniciimin dhe kryerjen e testeve të PVP-së;
- ë) përgaditjen e raporteve për testet dhe simulimet e kryera në gjendje krize dhe dorëzimin e tyre deri tek personi përgjegjës për sigurimin e vazhdueshmërisë në punë;
- f) përgaditjen e raporteve vjetore nga fusha e vet dhe dhënien e propozimeve dhe planeve për aktivitetet e ardhshme deri tek personi përgjegjës për vazhdueshmëri në punë dhe deri tek guvernatori i Bankës Popullore;
- g) pjesëmarrje në përgaditjen e planeve në fusha të reja (objekte të reja, shërbime të reja dhe zgjidhje alternative).

Grupe punuese për rindërtim

9. Udhëheqësi i grupës së krizës, sipas nevojës, mund të kërkojë prej Shtabit të Emergjencës të formojë grupë punuese për rindërtim të proceseve të punës (GPS), e cila do të përbëhet nga persona përkatës të punësuar në Bankë.

Shtabi Emergjencës në grupet e rindërtimit mund të përfshijë edhe bashkpunëtorë të jashtëm, të cilët do të bëjnë urdhëresa pune për tejkalimin e krizës.

Person përgjegjës për sigurimin e vazhdueshmërisë në punë në Bankën Popullore (PSVP)

10. Personi Përgjegjës Kryesor dhe Ndihmës Përgjegjës Kryesor për siguri të sistemit të informacionit, mbrojtje të të dhënave personale dhe informacioneve të klasifikuara nga Zyra për Strategji dhe Preventim janë persona përgjegjës për sigurimin e vazhdueshmërisë në punë (PSVP). PSVP-ja është e pavarur në funksionimin e saj dhe për punën e vet i përgjigjet vetëm guvernatorit të Bankës Popullore.

Detyrat dhe përgjegjësitë e PSVP-së janë këto:

- a) në bashkëpunim me udhëheqësit e grupeve të krizës e implementon PVP-ja;
- b) kujdeset për harmonizimin dhe kompletimin e Planeve për vazhdueshmëri në punë dhe akteve interne përkatëse;
- c) koordinon funksionimin e të gjitha grupeve të krizës gjatë gjendjes së krizës;

- ç) kontrollon dhe propozon qëllime dhe strategji shtesë PVP-së në përputhje me strategjinë afariste të Bankës Popullore;
- d) siguron ndihmë profesionale-teknike në funksionimin e ShE;
- dh) përgadit raporte vjetore për punën dhe propozon aktivitete në nivel vjetor të cilat i dorëzon deri tek guvernatori i Bankës Popullore;
- e) mbikëqyr dhe koordinon procesin e testimit dhe kontrollimit të PVP-së;
- ë) Nën-pika ë) fshihet;
- f) realizon aktivitete për njoftim të punonjësve me domethënien e PVP-së.

PSVP-ja dhe udhëheqësit e grupeve të krizës mbajnë takime në bazë të rregullt tremujorëshe dhe mes vete njoftohen për:

- a) ndryshimet e ndodhura në fushat për të cilat janë përgjegjës;
- b) mungesat / dobësitë në fushat të cilat janë përgjegjës.

11. Udhëheqësit taktik janë përgjegjës për:

- a) përcaktimin e rrezikshmërisë të proceseve të punës;
 - b) mbikëqyrje dhe menaxhim me rreziqet;
 - c) definimin e minimumit të burimeve të nevojshme dhe mjeteve teknike për funksionim me vëllim të zvogëluar në kushte të krijimit të gjendjes së krizës;
 - ç) përgaditje dhe rishikim të analizave të ndikimeve në gjendje krize në kryerjen e gjitha proceseve të punës në njësinë organizative (së paku një herë në vit);
 - d) përgaditje, rishikim dhe testim të planeve për vazhdueshmëri në punën e njësisë organizative;
 - dh) definimin e detyrave dhe përgjegjësi në njësinë organizative për funksionimin e saj në vëllim të zvogëluar në gjendje krize;
 - e) përgaditjen e Udhëzimit të funksionimit të njësisë organizative në kushte të mosfunksionimit të teknologjisë informative (udhëzime manuale);
 - ë) distribuim i planit përkatës për vazhdueshmëri në punë deri te të gjithë punonjësit në njësinë e vet organizative;
 - f) mbajtja e listave të përditësuara të kontaktëve të punonjësve në kushte krize të njësisë organizative me të cilën udhëheqin, përfshirë edhe për kontakt me bashkpunëtorë të jashtëm nga të cilët është i varur procesi punës.
12. Të punësuarit në Bankën Popullore detyrohen ti respektojnë PVP-të dhe planet përkatëse për sigurim të vazhdueshmërisë në punë dhe rimëkëmbje nga fatkeqësia e Bankës Popullore.
13. Në punën e Bankës Popullore zbatohet Plani i Vazhdueshmërisë në Punë, i cili përbëhet prej planeve përkatëse të vazhdueshmërisë në punë të njësive organizative të Bankës Popullore. Në kuadër të planeve të vazhdueshmërisë në punë të njësive organizative duhet të përfshihen edhe planet përkatëse për rimëkëmbje nga fatkeqësia (PRF).
14. Planet për vazhdueshmëri në punë të njësive organizative duhet të përmbajnë:
- a) parime dhe qëllime të planit;
 - b) minimumi i burimeve të nevojshme dhe mjete teknike për funksion me vëllim të zvogëluar në gjendje krize;
 - c) analizë të ndikimeve të krizës në të gjitha proceset e punës ndaj të gjitha proceseve të punës në njësinë organizative;
 - ç) organizim dhe procedurë për vendimarrje dhe raportim gjatë kohës së krizës;

- d) listë për të gjithë dokumentet të cilan kanë të bëjnë me planin;
- dh) përcaktim i shkallëve të krizave;
- e) udhëzime për procedura manuale të njësive organizative;
- ë) aktivitete dhe procedura të punonjësve në kushte krize;
- f) lokacion alternativ në Bankën Popullore ose në një tjetër objekt afarist;
- g) listë me kontakte, me të dhënat e personave përgjegjës; dhe
- gj) plan për rimëkëmbje të njësisë organizative nga fatkeqësia.

III. Komunikim dhe informim në gjendje krize të Bankës Popullore

- 15. Komunikimi me publikun në gjendje krize është përgjegjësi e ShE-së. Komunikimin me urdhër të ShE-së e bën person i autorizuar për komunikim me publikun. Ky person duhet të hartojë Plan të Komunikimit në Gjendje Krize.
- 16. Në gjendje krize kur inicohet aktivizimi i një pjese apo tërë plani i vazhdueshmërisë në punë, udhëheqësi i Grupës së Krizës informon rregullisht ShE-në për zhvillimin e ngjarjeve.

IV. Dispozita përfundimtare

- 17. Guvernatori i Bankës Popullore miraton akte të brendshme me të cilat realizohet PVP-ja.
- 18. Me hyrjen në fuqi të kësaj politike, ndalon së vlejti Politika për kontinuitet në punën e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë PKP nr. 02-15/VII-2/2006 nga 17.07.2006.
- 19. Kjo Politikë për Vazhdueshmërinë në Punë në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut hyn në fuqi në ditën e miratimit.

**Guvernatori
dhe kryesuesi
i Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë
Dimitar Bogov**